VENDIM
Nr.70, datë 12.10.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË OSSH SHA PËR VITIN 2009-2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. për miratimin e planit të investimeve për vitin 2009-2010,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e planit të investimeve për vitin 2009-2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta